



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Nr. 156 prot.

Kamëz, më 19.12 2018

V E N D I M

Nr. 144, datë 19.12 2018

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA PA KONKURRIM NË FAVOR TË SHOQËRISË “BIOPRODUCTS” SH.P.K TË PASURISË SË LLOJIT “ZALLISHTË”, ME SIPËRFAQE 12 400 (DYMBËDHJETË MIJË E KATËRQIND) M², ME NUMËR PASURIE 157, VOLUMI 3, FAQE 200, ZONA KADASTRALE 2372, LAKNAS NË PRONËSI TË BASHKISË KAMËZ

Këshilli Bashkiak Kamëz, i mbledhur më datë 19.12/2018, pasi mori në shqyrtim Projekt-Vendimin nr. 110, datë 11.12 /2018, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, shkronja “a” dhe “c”, nenit 54, shkronja “e” dhe nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 28, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 775, datë 05.09.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi osë në përdorim të Bashkisë Kamëz”, Ligjin nr.93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, VKM-ja nr. 709, date 29.10.2014, të këshillit të ministrave, “për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014–2020”, ndryshuar me VKM-në nr. 21, datë 12.01.2018, Pikës 5, shkronja “dh”, Pikës 6, shkronja “b”, gërma “i” , Kreu I, Kreun II, të vendimit nr. 54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”

të ndryshuar, Udhëzimi nr.13, datë 26.04.2018 “Për zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, kërkesës së subjektit “Bioproducts” sh.p.k, ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut”, Këshilli Bashkiak Kamëz,

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim të dhënies me qira pa konkurim në favor të shoqërisë “Bioproducts” sh.p.k për një periudhë prej 20 (njëzet) vjet të pasurisë së llojit “Zallishte”, me sipërfaqe 12 400 m², me numër pasurie 157, Volumi 3, Faqe 200, zona kadastrale 2372, Laknas kaluar në pronësi të Bashkisë Kamëz me vendimin nr. 775, datë 05.09.2013 të Këshillit të Ministrave dhe regjistruar në ZVRPP me çertifikatën e pronësisë nr.1842744, lëshuar më datë 09.11.2018, sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky proces të kryhet sipas përcaktimeve të Pikës 5, shkronja “dh”, Pikës 6, shkronja “b”, gërma “i” , Kreu I, Kreun II, të vendimit nr. 54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar.
3. Shoqëria “Bioproducts” sh.p.k të përdorë pasuritë e mësipërme për ushtrimin e aktivitetit të saj sipas objektit të parashikuar në Plan-Biznesin e paraqitur në kërkesën për marrjen me qira.
4. Vlera e qerasë do të jetë sipas kërkesës së paraqitur nga subjekti “Bioproducts” sh.p.k.
5. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, si dhe për lidhjen e kontratës së qirasë.

Bilbil BAJRAKTARI

KRYETAR

